



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.10/2017

Prishtinë, më 1shkurt 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Saranda Bogujevci, Mirjeta Kalludra, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj- Gutaj, Teuta Haxhiu dhe Albulena Balaj Halimaj.

Mungoi: Miljana Nikoliq, Frashër Krasniqi dhe Mytahir Haskuka.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE, Vlora Nushi-OPA/UNMIK, Adelina Hasani-KDI dhe Agnesa Haxhiu-KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

- 1. Organizimi i konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri;**
- 2. Të ndryshme.**

1. Organizimi i konferencës rajonale mbi pozitën e femrës në shoqëri

Kryetarja tha se në mbledhjen e kaluar kemi diskutua rreth organizimit të kësaj konference, se komisionet homologe të cilave vende t'i ftojmë, sa ditë do të zgjatë konferenca, si dhe për

temat e diskutimit, por nuk kemi vendosur meqë nuk kishim numrin e nevojshëm të anëtarëve të komisionit prezent.

Më pas, ajo hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Teuta Haxhiu, sa u përket temave që do të diskutohen në këtë konferencë, propozoi të jenë tri tema: si dhuna në familje, zbatimi i ligjit për trashëgimi dhe e drejta në pronë, si dhe buxheti gjinor.

Ajo theksoi se pasi që nuk do të jetë e pranishme deri në fund të kësaj mbledhje, do të mbështesë vendimet që do të marrë Komisioni Funkcional.

Saranda Bogujevci tha se është mirë ditën e dytë të mbajtjes së konferencës mysafirët t'i dërgojmë në ndonjë Institucion të rëndësishëm.

Ajo u shpreh e gatshme që të ndihmojë në vazhdimësi për organizimin e kësaj Konference.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se pajtohet që temë diskutimi të jetë buxheti gjinor dhe se në kuadër të programit të veçantë për mysafirët të vizitohet ndonjë vend interesant. Ajo theksoi se do të ishte mirë të vendosim se përfaqësuesit e cilave institucione vendore, do t'i ftojme në këtë konferencë.

Mirjeta Kalludra tha se është mirë që tema për personat me aftësi të kufizuara, e propozuar në këtë draft agjendë të zëvendësohet me temën nga E drejta e femrës në pronë apo trashëgimi.

Albulena Balaj-Halimaj pati dilema për emrin e Konferencës dhe propozoi që termi grua të zëvendësohet me termin femër.

Lirije Kajtazi propozoi që moto e Konferencës rajonale të jetë – “bashkëpunimi për fuqizim”, si dhe të jetë për diskutim edhe një temë për integrim evropian sepse është temë me rëndësi. Për këtë temë t'i mundësohet të referojë delegacioni nga Kroacia, meqenëse ky shtet tashmë i ka kaluar këto sfida të integritit evropian.

Kryetarja tha se sa u përket të ftuarave do të ftohet edhe Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së, në Kosovë, znj. Apostollova, dhe ajo do të ketë një fjalë rasti, pas Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit.

Kryetarja konstatoi, se komisioni vendosi të mbajë Konferencë Rajonale e cila do të titullohet „Konferenca rajonale e gruas, bashkëpunimi për fuqizim”, konferenca të zgjasë dy ditë, të organizohet në „Hotel Sirius” në Prishtinë.

Ndërsa për diskutim të ndonjë elementi tjetër organizativ të Konferencës, tha se më 2 shkurt 2018, të gjithë anëtarët e Komisionit FunkSIONAL, do të takohemi në zyrën e saj, si dhe Administrata e Komisionit, ku do të përgatisim agjendën finale të konferencës.

2. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati deputetë të paraqitur për fjalë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

*E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje